


Projektbuxheti 2026

Analizë e të hyrave dhe
shpenzimeve buxhetore



Projektbuxheti 2026

Analizë e të hyrave dhe
shpenzimeve buxhetore

Shkurt 2026

Përmbledhje ekzekutive

Qeveria e Kosovës miratoi me 12 shkurt 2026 projektbuxhetin e vitit 2026. Verzioni i miratuar është i njëjti me atë që Qeveria në detyrë e kishe miratuar me 31 tetor 2025 dhe nuk reflekton strukturën e Qeverisë së re, që tani do të ketë 19 ministri. Po ashtu, ky projektbuxhet nuk është përgatitur bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), e cila nuk është miratuar dhe publikuar fare për periudhën 2026–2028.

Buxheti i Kosovës për vitin 2026 parasheh gjithsej shpenzime rreth 4 miliardë euro, një rritje prej 10% krahasuar me vitin 2025. Shpenzimet rrjedhëse pritet të rriten për 279 milionë euro (+11%) dhe të arrijnë në rreth 2.9 miliardë euro, duke zënë 73% të buxhetit, ndërsa shpenzimet kapitale rriten për 67.1 milionë euro (+7%) dhe kapin vlerën 998.4 milionë euro, ose 25% të buxhetit. Gjatë periudhës 2019–2025, shpenzimet për subvencione dhe transfere pothuajse janë dyfishuar si vlerë, ndërkaq investimet kapitale janë rritur vetëm për rreth 35%. Ky zhvillim i tillë kufizon mundësinë për të investuar në projekte infrastrukturore, ndonëse investimet publike kanë një efekt multiplikues shumë të lartë në ekonomi.

Buxheti total i nivelit qendror (ministrior), pa përfshirë pagesat për interesin e borxhit publik, do të jetë rreth 3 miliardë euro (+9.6% krahasuar me 2025), ndërkaq ai i nivelit lokal rreth 867 milionë euro (+10.1% krahasuar me 2025). Pjesa më e madhe e rritjes së buxhetit tek niveli qendror në vitin 2026 shkon tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, që do të ketë rritje prej rreth 174 milionë eurove apo 17%. Krahasuar me vitin 2025, tek kjo ministri, kategoria e pagesave për pensione planifikohet të rritet për 95 milionë euro apo 20% në vitin 2026, skema për lehonat dhe shtesat për fëmijë për 75 milionë euro apo 52%, duke arritur në 220 milionë euro si skemë, etj. Buxheti për shëndetësi në vitin 2026 parashihet të arrijë në rreth 396 milionë euro, me rritje prej 10% krahasuar me vitin 2025, kurse buxheti për arsim arrin në rreth 408.7 milionë euro, apo 6% më shumë se në vitin 2025. Ndërkaq, buxheti për sektorin e drejtësisë shënon rritje prej rreth 2%, kryesisht për institucionet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Në sektorët tjerë, buxheti nuk dallon shumë nga viti i kaluar, si dhe nuk adresohen nevojat nga aspekti buxhetor për zbatimin efektiv të strategjive kyçe për ekonominë tonë, sikurse

për Strategjinë e Energjisë.

Për herë të parë në projektbuxhet përfshihet edhe paga e 13-të për sektorin publik. Megjithëse rritja e përgjithshme e faturës së pagave mbetet brenda kufijve të lejuar fiskalë, ajo nuk është në harmoni me Ligjin e pagave dhe përfaqëson ndërhyrje ad-hoc në politikën e pagave, siç ishte rasti edhe vitin e kaluar me ndryshimin e koeficientëve.


Mbi 81% e buxhetit të projekteve kapitale në vitin 2026 është për projektet që do të vazhdojnë nga vitet e kaluara, ndërsa projektet e reja mbeten të kufizuara si në numër ashtu edhe në vlerë dhe kryesisht janë projekte të vogla. Edhe pse në vitet 2024 dhe 2025 është shënuar përmirësim në shkallën e realizimit të investimeve, nivelet e fondeve të pashpenzuara mbeten të larta marr parasysh nevojën në ekonomi për investime. Mosrealizimi i investimeve kapitale ka krijuar kosto të konsiderueshme oportune për ekonominë dhe qytetarët. Vetëm gjatë periudhës 2021–2024, realizimi i investimeve kapitale ka qenë rreth 1 miliard euro më i ulët se planifikimi, duke reflektuar dobësi të vazhdueshme në planifikimin dhe zbatimin e projekteve kapitale.

Shpërndarja e investimeve kapitale nga niveli qendror në komuna vazhdon të jetë joproporcionale me popullsinë dhe sipërfaqen, ndonëse më e balancuar nga aspekti partiak, duke nxjerrë në pah pabarazi. Aktualisht, 11 komuna e kanë miratuar buxhetin e vitit 2026 me vonesë, por që Kuvendi i Kosovës ka hapësirë ligjore që t'ua ndryshojë kufijtë e buxhetit mes dy leximeve të këtij projektligji. Një praktikë pozitive në projektbuxhet është se Ministria e Financave nuk i ka ulur buxhetet e komunave me rënie të popullsisë, duke mos i penalizuar ato dhe duke marrë parasysh se nevojat për investime mbeten të larta.

Dokumenti informues për qytetarët rreth projektbuxhetit nuk publikohet me kohë as këtë vit, ndonëse praktikë e mira kërkon një përmbledhje të qartë të ndryshimeve dhe politikave buxhetore. Po ashtu, projektbuxheti vazhdon të mos adresojë perspektivën gjinore, duke munguar analiza e ndikimit dhe masat për promovimin e barazisë gjinore.

Rritje prej rreth 10% e shpenzimeve buxhetore në vitin 2026, duke arritur vlerën rreth 4 miliardë euro, me varësi të ulët në borxhin publik. Nga gjithsej shpenzimet e planifikuara, 3.64 miliardë euro ose rreth 92%, do të financohen nga të hyrat e rregullta buxhetore, ndërsa 330.3 milionë euro ose 8%, do të mbulohen përmes financimit shtesë. Të hyrat buxhetore për vitin 2026 janë parashikuar të jenë rreth 3.6 miliardë euro, që është 331.6 milionë euro më shumë, apo 10% rritje krahasuar me vitin 2025. Kjo rritje lidhet kryesisht me pritjet për një performancë më të mirë fiskale, sidomos në mbledhjen e të hyrave tatimore nga tatimet indirekte. Kontributi kryesor në rritjen e të hyrave pritët të vijë nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), me një rritje prej gjithsej 176.3 milionë euro. Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje vjen nga TVSH-ja kufitare, ndërsa tutje kontribuojnë edhe të hyrat nga akcizat dhe tatimi mbi të ardhurat personale.

Figura 1. Struktura e financimit të buxhetit të Kosovës (në miliona euro)



Burimi: Instituti GAP, me të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

Figura 2. Rritja e shpenzimeve rrjedhëse dhe kapitale




Burimi: Instituti GAP, me të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT.

Nga ana tjetër, nevoja për financim për vitin 2026 është rritur në 330.3 milionë euro (+10%), nga 300 milionë euro që ishte në vitin 2025. Por, mbi 90% e financimit të shpenzimeve planifikohet të bëhet nga të hyrat buxhetore dhe borxhi publik mbetet ende në nivel të ulët, rreth 16.4% të Bruto Produktit Vendor (BPV).

Sa i përket strukturës së shpenzimeve, pjesa më e madhe e tyre përbëhet nga shpenzimet rrjedhëse, të cilat arrijnë në 2.9 miliardë euro, ose rreth 73% të gjithsej shpenzimeve (subvencione dhe transfere me 34%, paga dhe mëditje me 25%, mallra dhe shërbime me 13%, si dhe shpenzime komunale me 1%). Shpenzimet kapitale, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e zhvillimit ekonomik, janë planifikuar në 998.4 milionë euro, që përbën rreth 25% të gjithsej shpenzimeve të buxhetit.

Rritje më e përshpejtuar e shpenzimeve rrjedhëse se atyre kapitale në vitin 2026. Në krahasim me vitin 2025, shpenzimet rrjedhëse parashikohet të rriten me 279 milionë euro apo 11%, ndërsa shpenzimet kapitale pritët të rriten për 67.1 milionë euro apo 7%.


Figura 3. Rritja e shpenzimeve kapitale dhe rrjedhëse 2021–2026



Burimi: Instituti GAP, me të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT.

Duke u fokusuar më tej te shpenzimet rrjedhëse, rritja më e madhe parashikohet te subvencionet dhe transferet, të cilat pritet të arrijnë rreth 1.4 miliardë euro (201.4 milionë euro ose 17% më shumë krahasuar me vitin 2025). Pagat dhe shtesat planifikohen të rriten në 980.4 milionë euro (63.5 milionë euro, ose 7% më shumë), ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime pritet të arrijnë në 545.4 milionë euro (8.4 milionë euro, ose 2% më shumë).

Figura 4. Rritja e shpenzimeve rrjedhëse në miliona euro, 2023–2026




Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT.

Në periudhën 2019–2025, shpenzimet për subvencione dhe transfere kanë pasur një rritje të hovshme, gati se duke u dyfishuar. Kjo kryesisht për shkak të pagesave për politika sociale, përfshi shtesa të reja dhe rritje të vlerës së pagesave për skemat e vjetra, sikurse rritjes e shtesave për skemën për gratë lehona dhe shtesat për fëmijët (75 milionë euro apo +52% vs. 2025), rritje e pensione (91 milionë euro apo +16% vs. 2025), etj. Ndërkaq, në të njëjtën periudhë shpenzimet kapitale janë rritur për vetëm 35%.

Në aspektin buxhetor, **rritja e ndjeshme për shpenzimet rrjedhëse, veçanërisht për subvencione dhe transfere, kufizon mundësinë për të investuar në projekte infrastrukturore.** Kjo bëhet edhe më e theksuar, kur për shkak të problemeve me kapacitetet profesionale për zbatimin e projekteve¹, institucionet publike nuk janë efikase por as nuk shfaqin angazhim serioz në realizimin e investimeve kapitale të financuara nga institucionet ndërkombëtare financiare. Sa i përket shpenzimeve rrjedhëse, veçanërisht kategorisë me peshën më të madhe, asaj të subvencioneve dhe transfereve, aktualisht nuk ka asnjë rregullë fiskale në bazën ligjore që vë një kufi se sa mund të jetë rritja vjetore. E për vendet e Ballkanit Perëndimor, investimet publike, sidomos duke pasur parasysh nevojat e mëdha infrastrukturore për investime, luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e investimeve private. Konkretisht, një studim² i Bankës Botërore gjen se për çdo 1 euro të investuar nga sektori publik, nxiten rreth 0.7 euro investime shtesë nga sektori privat.

Figura 5. Rritja e shpenzimeve për subvencione dhe kapitale 2015–2025 (2019=100)



Instituti GAP duke përdorur të dhënat e MFPT dhe ASK. Shënim: Shpenzimet e muajit dhejtor 2025 janë përllogaritur bazuar në trendin e viteve të kaluara dhe në përllogaritjet e prezantuara nga institucionet financiare ndërkombëtare.

¹ Komisioni Evropian. [Raporti për vendin 2025](#) (f.53) dhe Zyra Kombëtare e Auditimit. [Raporti vjetor 2024](#) (f.83)

² Grupi i Bankës Botërore. (2025). [Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor nr. 28](#) (f. 21). Banka Botërore.

Shpenzime më të larta për pagat e sektorit publik për arsye të pagës së 13-të – jo në harmoni me Ligjin e pagave.


Në vitin 2026, për herë të parë punonjësit e sektorit publik që kanë të paktën 12 muaj shërbim do të marrin pagën e 13-të. Gjithashtu, pagat në këtë sektor do të rriten më shumë përmes indeksimit të përvojës, nga 0.25% në 0.5% për vit pune. Ndonëse rritja në faturën e pagave është në harmoni me kufirin e lejuar të rritjes sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, duke mos e kaluar normën nominale të rritjes së ekonomisë, dhënia e pagës së 13-të nuk parashihet tek kategoritë e shtesave apo kompensimeve tek Ligji i pagave, i cili edhe e rregullon këtë fushë.³ Kjo është hera e dytë që përmes Ligjit të buxhetit rregullohen çështje të pagave jo në harmoni me formën e rregullimit që bën Ligji i pagave.

Rritje e buxhetit të nivelit qendror dhe lokal për rreth 10%. Buxheti total i nivelit qendror, pa përfshirë pagesat për interesin e borxhit publik, do të jetë rreth 3 miliardë euro (+9.6% krahasuar me 2025), ndërkaq ai i nivelit lokal rreth 867 milionë euro (+10.1% krahasuar me 2025). Tek shpenzimet sipas kategorive ekonomike, përdërsa në nivelin qendror tani dominon kategoria e subvencioneve dhe transfereve, në nivelin lokal dominon ajo e pagave. Pra, tek të dy nivelet shpenzimet më të larta janë për kategori rrjedhëse.

Investimet kapitale për vitin 2026 janë buxhetuar të jenë rreth 986.7 milionë euro apo 7% më shumë se në vitin 2025. Nga kjo shumë, 801.6 milionë euro, ose 81%, janë të dedikuara për vazhdimin e projekteve ekzistuese, ndërsa rreth 185 milionë euro, ose 19%, janë planifikuar për investime kapitale të reja. Rreth 76% e gjithsej investimeve kapitale, ose afërsisht 751 milionë euro janë buxhetuar për nivelin qendror, ndërsa 24% ose rreth 236 milionë euro për nivelin lokal.


Mbi 81% e buxhetit të projekteve kapitale në vitin 2026 është për projektet që do vazhdojnë nga vitet e kaluara. Konkretisht, 801.6 milionë euro ose 81%, janë të dedikuara për vazhdimin e projekteve ekzistuese, ndërsa rreth 185 milionë euro, ose 19%, janë planifikuar për investime kapitale të reja. Rreth 76% e gjithsej investimeve kapitale, ose afërsisht 751 milionë euro janë buxhetuar për nivelin qendror, ndërsa 24% ose rreth 236 milionë euro për nivelin lokal.

Figura 6. Buxheti i nivelit qendror atij lokal, 2023–2026



Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT.

Figura 7. Buxheti i nivelit qendror dhe atij lokal sipas kategorive ekonomike, 2023–2026



³ Gazeta Zyrtare. Ligji nr. 08/I-196 për pagat në sektorin publik.

Nga gjithsej 801.6 milionë euro të alokuara për projektet e vazhduara, 79% ose 629.4 milionë euro janë të destinuara për nivelin qendror, ndërsa 21% ose 172.2 milionë euro për komunat. Ndërkaq, nga rreth 185.1 milionë euro të parashikuara për projektet e reja kapitale, 66% ose rreth 121.5 milionë euro janë alokuar për nivelin qendror, ndërsa pjesa e mbetur prej 34% ose 63.6 milionë euro për nivelin lokal.


Tek investimet kapitale në nivelin lokal, duhet theksuar se Instituti GAP ka evidentuar në një analizë⁴ se një pjesë e madhe e buxhetit nga kjo kategori, veçanërisht tek komunat e mëdha, është duke u përdorur për të paguar obligimet gjyqësore që rrjedhin nga kontratat kolektive dhe të tjera, ndonëse të njëjtat shpenzime vazhdojnë të raportohen si shpenzime kapitale, duke mos pasqyruar saktë realizimin e investimeve kapitale.

Investimet kapitale karakterizohen nga projekte realitivist të vogla. Në projektbuxhetin e vitit 2026 nuk dallohen projekte të mëdha infrastrukturore që do të nisin së zbatuari, nga të cilat edhe pritët zgjerimi i infrastrukturës apo përmirësime thelbësore. Kryesisht dominojnë projektet me vlerë rreth 1 milion euro. Po ashtu, tek projektet më të mëdha të filluara viteve të kaluara, shkalla e alokimit të buxhetit për to në vitin 2026, mbetet jo e lartë, me vetëm buxhetet për trasetë e autostradave në drejtim të Pejës dhe Gjilanit që kapin vlerën mbi 18 milionë euro secila, të tjerat janë projekte më të vogla, kryesisht më të vogla se 2 milionë euro.

Investimet e mëdha infrastrukturore, të parapara të bëhen përmes kredive, tek klauzola e investimeve, çdo vit karakterizohen me shkallë realizimi të ulët, rreth 14% (2023 dhe 2024). Kjo kryesisht për shkak se institucionet vendore kanë mungesë të kapaciteteve profesionale⁵ që të përmbushin edhe kriteret dhe kërkesat e donatorëve që mbështesin ato projekte, sikurse ato teknike, të raportimit, etj.


Rreth 1 miliard euro investime kapitale të përpilizuara në katër vite. Mjetet buxhetore të papërdorura për investime kapitale në Kosovë, duke mos realizuar investimet sipas planifikimit, shënojnë vlera relativisht të larta. Mos realizimi i investimeve ka një kosto oportune, ku qytetarët nuk mund të përfitojnë nga shërbimet më të mira, qasje në infrastrukturë më të mirë, bizneset nuk mund të zgjerojnë veprimtarinë e tyre, etj. Vetëm në katër vitet gjatë periudhës 2021–2024, realizimi i investimeve kapitale ishte për rreth 1 miliard më i ulët se planifikimi.

Figura 8. Investimet e reja kapitale krahas atyre të vazhduara (për nivelin qendror (NQ) dhe nivelin lokal (NL))



Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

Figura 9. Fondet e pashfrytëzuara të buxhetit për investime kapitale, 2016–2024




Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

⁴ Instituti GAP. (2025). [Paraqitja jo e saktë e realizimit të investimeve kapitale të komunave: implikimet në transparencë dhe monitorim](#)

⁵ Zyra Kombëtare e Auditimit. [Raporti vjetor 2024](#) (f.83)

Përmirësim në dinamikën e realizimit të investimeve kapitale në vitin 2024 dhe 2025. Investimet kapitale luajnë një rol kyç dhe ofrojnë potencial të madh për nxitjen e zhvillimit ekonomik. Në vitin 2024, realizimi i buxhetit për investime kapitale arriti 76%, duke shënuar një përmirësim prej shtatë pikë përqindjeje krahasuar me vitin paraprak. Trend i tillë ekzekutimi dallohet edhe tek te dhënat e vitit 2025. Për ekonominë tonë, është tejet me rëndësi të realizohen sa më shumë projekte gjatë vitit. Raporti vjetor i Komisionit Evropian për vitin 2025 konfirmon se një nga sfidat kryesore mbetet planifikimi i kujdesshëm dhe zbatimi efektiv i projekteve kapitale.⁶

Figura 10. Trendi i realizimit të investimeve kapitale në Kosovë, 2016- 2024



Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

Projektbuxheti nuk rreflekton strukturën e re të Qeverisë. Ndonëse Qeveria e re, e votuar nga Kuvendi i Kosovës më 11 shkurt 2026 ka 19 ministri, katër më shumë se vitin e kaluar, ky projektbuxhet nuk e reflekton këtë ndryshim. Kjo paraqet një praktikë jo të mirë në procesin e miratimit të Ligjit të Buxhetit. Tek 15 ministrinë e paraqitura në projektbuxhetin për vitin 2026, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve menaxhon 46% të buxhetit të tërësishëm të ministrive. Po ashtu, kjo ministri do ta ketë edhe rritjen më të madhe të buxhetit, rreth 63% të të gjithë rritjes së buxhetit të ministrive së bashku. Krahasuar me vitin 2025, kosto e pensioneve planifikohet të rritet për 95 milionë euro apo 20%, pagesat për shtesat për fëmijë dhe gratë lehona 75 milionë euro apo 52%, etj. Tek institucionet e rëndësishme për ekonominë në kuadër të kësaj ministrie, rritje të buxhetit prej 8 milionë eurove apo 28% do të ketë Agjencia e Punësimit, në kuadër të së cilës realizohen edhe programe sikur ajo e Superpunës. Ndërkaq, Inspektorati i Punës do të ketë buxhet prej 4.9% apo 800 mijë euro më të lartë se në vitin 2025, por jo edhe rritje të numrit të lejuar të punëtorëve.


⁶ Komisioni Evropian. [Commission Staff Working Document, Kosovo* 2025 Report](#). Qasur së fundmi më 30 janar 2026.

Po ashtu, tek Ministria e Ekonomisë planifikohet rritje e buxhetit mbi 38 milionë euro, që kryesisht vjen nga rritja e investimeve kapitale tek klauzola e investimeve (ndërtimi i pesë impianteve nëpër komuna). Rritje të buxhetit do të ketë edhe Ministria e Shëndetësisë prej 23% apo 19 milionë euro, Ministria e Kulturës për 13% apo 11.6 milionë euro, Ministria e Arsimit për 10% apo 10 milionë euro, Ministria e Mbrojtjes për 3% apo 8 milionë euro, etj. Kurse nga ministritë më rënien më të lartë të buxhetit janë Ministria e Zhvillimit Rajonal me 29% apo 2.1 milionë euro më pak buxhet se në 2025, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me 28% apo 2.5 milionë euro më pak, etj.

Figura 11. Buxheti i 15 ministrive, 2025–2026



Figura 12. Ndryshimi i buxhetit të ministrive në vitin 2026




Ministria e Ekonomisë pa buxhet të mjaftueshëm për zbatimin e Strategjisë së Energjisë. Tek buxheti i Ministrisë së Ekonomisë mbizotërojnë projektet e ndara në kuadër të Klauzolës së Investimeve dhe subvencionet për ndërmarrje publike. Ndërkaq, ndonëse ministria ka përcaktuar objektiva në Strategjinë e Energjisë që kërkojnë mobilizim të theksuar të fondeve publike, veçanërisht për uljen e konsumit përmes investimeve në efikasitet të energjisë, kjo nuk reflektohet në dinamikën e shpenzimeve tek buxheti vjetor. Për pasojë, arritja e cakut prej 283 ktoe kursimi, të paraparë në kuadër të objektivit për efikasitet të energjisë në Strategjinë e Energjisë 2022–2031, mbetet tejte e vështirë. Kjo sidomos duke pasur parasysh se, sipas një studimi të GAP⁷, realizimi i këtij objekti kërkon mobilizimin e investimeve vjetore nga të gjithë akterët në treg prej mbi 30 milionë eurove çdo vit.

7 Instituti GAP. (2024). [Mbështetja e qeverive për përmirësimin e efikasitetit të energjisë si një përgjigje ndaj zbutjes së goditjeve \(të ardhshme\) energjetike: Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor](#) (Raport).

Buxheti i sektorit të shëndetësisë për vitin 2026 është planifikuar të arrijë rreth 396 milionë euro, me një rritje prej 37.4 milionë euro apo 10% krahasuar me vitin 2025. Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë pritet të rritet me 23%, ose 19 milionë euro, krahasuar me vitin 2025. Buxheti për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore mbetet thuajse i pandryshuar, me një rënie minimale prej vetëm 1%. Buxheti për shërbimet spitalore ka një rritje modeste prej 4%. Kjo tregon rritje të vogël për përmirësim të shërbimeve spitalore ose përmbushje të nevojave të zakonshme operative. Edhe granti komunal ka një rritje të vogël, rreth 4%.

Figura 13. Buxheti për shëndetësi (në miliona euro), 2025-2026




Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

Kosova gjatë vitit 2025 ka ndërmarrë disa hapa konkret për shëndetësinë, përfshirë këtu dhe miratimin e Strategjisë 2025-2030 dhe Planin Kombëtar për Sigurinë Shëndetësore.⁸ Megjithatë, shpenzimet për shëndetësinë mbeten të ulëta. Analiza e shpenzimeve të planifikuara për sektorin e shëndetësisë në Kosovë për vitin 2026 tregon se shpenzimet në shëndetësi vazhdojnë të përbëjnë vetëm 3.9% të Bruto Produktit Vendor (BPV).

Në krahasim me vendet e tjera evropiane, Kosova mbetet prapa shumicës së tyre. Në krye të listës janë Republika Çeke dhe Franca (8.9% dhe 8.8%), ndjekur nga Islanda (8.2%), Kroacia (7.8%), Suedia (7.4%), si dhe tutje Greqia, Irlanda, Malta, Rumania dhe Hungaria, të cilat tregojnë një angazhim më të lartë financiar ndaj shëndetësisë. Nga ana tjetër, vetëm Zvicra investon më pak se Kosova, me rreth 2.2% të BPV-së, duke reflektuar një qasje më të ulët ndaj financimit të shëndetësisë.

Përparim është bërë në parandalimin e sëmundjeve, digjitalizim dhe disa fusha të tjera, por sfidat kryesore janë zbatimi i ngadaltë, cilësia e ulët e kujdesit, pabarazia në qasje, mbulimi i pamjaftueshëm i sëmundjeve jo-ngjitëse dhe përdorimi i joefikas i fondeve.⁹

Figura 14. Niveli i shpenzimeve në shëndetësi (% e BPV-së) në Kosovë krahasuar me vendet evropiane, 2022



Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, ASK dhe MFPT


⁸ Komisioni Evropian. [Commission Staff Working Document, Kosovo* 2025 Report](#), Qasur së fundmi më 15.02.2026.

⁹ Komisioni Evropian. [Commission Staff Working Document, Kosovo* 2025 Report](#), Qasur së fundmi më 15.02.2026.

Buxheti për arsimin dhe institucionet arsimore në Kosovë është 408.7 milionë euro dhe tregon një rritje të përgjithshme prej 6%, ose 23.7 milionë euro, për vitin 2026 krahasuar me vitin 2025. Granti komunal për arsim rritet me 11.5 milionë euro (5%), duke treguar një përkushtim të vazhdueshëm për mbështetjen e arsimit lokal. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) shënon një rritje prej rreth 10 milionë euro (10%), duke reflektuar angazhime për përmirësimin e shërbimeve dhe projekteve arsimore. Universiteti i Prishtinës (UP) ka një rritje modeste prej 1.78 milionë euro (5%), duke siguruar mbështetje për zhvillimin akademik dhe infrastrukturën universitare. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës (ASHAK) shënon një rritje më të madhe, 17% ose 298 mijë euro, që tregon një angazhim për forcimin e arsimit të mesëm dhe profesional. Akademia e Drejtësisë rritet me 23 mijë euro (3%), duke reflektuar një rritje të qëndrueshme por të vogël në buxhetin e saj.


Në tërësi, kjo tregon një angazhim të qëndrueshëm për financimin e arsimit, me rritje më të larta për institucionet si MASHT dhe ASHAK.

Figura 15. Buxheti për arsim, 2025–2026



Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

Në vitin 2023, shpenzimet për arsimin si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV) në Kosovë ishin 4%, duke e vendosur vendin nën mesataren e Bashkimit Evropian, e cila është 4.7%, dhe poshtë shumicës së vendeve të tjera që tregojnë angazhim më të lartë financiar ndaj sektorit të arsimit. Në krye të listës janë vendet nordike dhe baltike, si Suedia me 7.3%, Islanda me 6.7%, Estonia dhe Finlanda me 6.3% dhe Letonia me 6.1%, të cilat tregojnë një angazhim të lartë financiar, shumë mbi mesataren e BE-së dhe dukshëm mbi Kosovën. Në një nivel të moderuar, vendet si Lituania me 5.1% dhe Austria me 4.9% investojnë gjithashtu më shumë se Kosova. Në grupin e vendeve që investojnë më pak, krahas Kosovës, janë Republika Çeke me 4.5%, Malta me 4.1%, Italia me 3.9% dhe Irlanda me 2.8%, duke treguar se disa vende të BE-së investojnë më pak se mesatarja, por Kosova mbetet në fundin e spektrit të investimeve për arsim.


Figura 16. Niveli i shpenzimeve në arsim (% e BPV-së) në Kosovë krahasuar me vendet evropiane, 2022

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat, ASK dhe MFPT


Buxheti për sektorin e drejtësisë në Kosovë për vitin 2026 tregon rritje prej 2.87 mil eurove apo 2% krahasuar me vitin paraprak. Nga institucionet e këtij sektori, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) shënon një rritje prej rreth 2.5 milionë euro (7%), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) me 707.7 mijë euro ose 4% më shumë. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) ka një rritje prej 75.3 mijë euro (13%), ndërsa Akademia e Drejtësisë (AD) ka një rritje më të ulët prej 23 mijë euro. Për dallim, Ministria e Drejtësisë ka rreth 274.3 mijë euro (-0.5%) më pak buxhet, ndërsa Agjencia Kundër-Korrupsionit shënon ulje rreth 119.6 mijë euro (-11%).

Buxheti për komunat për vitin 2026 tregon rritje në të gjitha kategoritë të shpenzimeve krahasuar me vitin 2025. Pagat rriten me 48.8 milionë euro (13%), mallrat dhe shërbimet rriten me 6.78 milionë euro (5%), ndërsa shpenzimet komunale rriten me 1.6 milionë euro (10%). Subvencionet dhe transferet shënojnë rritje prej 6.02 milionë euro (17%). Kurse, investimet kapitale rriten me 16.6 milionë euro (7%).

Buxheti i 11 komunave duhet të rishikohet me dy leximeve të buxhetit. Për shkak të zgjedhjeve komunale por edhe mos informimit të mirë të shumë asambleistëve rreth pasojave të mos miratimit të buxhetit vjetor sipas afateve të rregullta, 11 komuna (Vushtrria, Suhareka, Vitia, Lipjani, Malisheva, Shtimja, Juniku, Zubin Potoku, Gjlani, Prizreni dhe Prishtina) nuk e kishin miratuar buxhetin vjetor deri më 30 shtator 2025. Për rrjedhojë, ato rrezikojnë që në vitin 2026 të kenë buxhetin e njëjtë si në vitin 2025 dhe jo me një rritje, siç edhe reflektohet në projektbuxhetin aktual. Por, meqë projektbuxheti është ende mes

Figura 17. Buxheti për disa institucione të sundimit të ligjit

Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

Figura 18. Gjithsej buxheti i komunave sipas kategorive, 2025 dhe 2026

Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

dy leximeve, deputetët e Kuvendit të Kosovës munden lehtësisht në thirrje të nenit 62.3 të Ligjit për menaxhimin e financave publike¹⁰ dhe përgjegjësitë ta amandamentojnë atë, që për komunat të cilat pas zgjedhjeve komunale veçse e kanë miratuar buxhetin e vitit 2026 dhe dorëzuar atë në Ministrinë e Financave (MFPT), ta bëjnë plotësimin e buxhetit të këtyre komunave. Përmes kësaj, këto komuna do të marrin buxhet të rritur sikur komunat tjera, sipas metodologjisë së llogaritjes së buxhetit.


Ministra e Financave nuk ka ulur buxhetin e komunave me rënie të popullsisë. Një praktikë e mirë e ndeshur në projektbuxhet është se përkundër se disa nga komunat janë ndikuar negativisht tek numri i popullsisë në regjistrimin e fundit, Minsitria e Financave asnjëherë prej tyre nuk i ka alokuar buxhet më të ulët se buxheti i tyre në vitin e fundit, duke mos i penalizuar ato, marr parasysh se nevojat për investime nëpër komuna ende janë shumë të larta.

Ende nuk është themeluar Granti i katërt për komunat dhe vazhdojnë dallimet mes komunave në përfitimin e investimeve nga qendra. Ndonëse Granti i Katërt ishte ideuar me qëllimin për të mënjeluar diskriminimin ndaj komunave, i njëjti nuk është themeluar ende. Për rredhojë, mënyra e shpërndarjes së buxhetit nga niveli qendror nëpër komuna vazhdon të mbetet në diskrecionin e tërësishëm të ministrave gjegjë. Në vitin 2026, ministrinë planifikohen të investojnë nëpër komuna 216.6 milionë euro apo rreth 29% të buxhetit që kanë për investime. Nga to, si investime të reja kapitale janë 15 milionë euro, që përfaqëson rreth 32% më pak (afërsisht 7 milionë euro më pak) krahasuar me vitin 2025. Nga këto fonde të reja, do të përfitojnë 23 komuna. Ndërsa pjesa tjetër e komunave, përfshirë disa të mëdha si Prishtina, Ferizaji dhe Fushë Kosova, nuk kanë marrë asnjë investim.

Shpërndarja e investimeve nga niveli qendror në komuna nuk është plotësisht proporcionale me popullsinë dhe sipërfaqen, duke nxjerrë në pah pabarazi në alokimin e investimeve. Lëvizja Vetëvendosje (LVV) përfiton pjesën më të madhe të investimeve, me 40.3% të investimeve totale dhe 34% të investimeve të reja, ndonëse përfaqëson 23.8% të popullsisë dhe 18.3% të sipërfaqes. Një situatë e ngjashme, sidomos sa i përket investimeve të reja, vërehet edhe te Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e cila me 14.0% të popullsisë dhe 16.8% të sipërfaqes përfiton 29.5% të investimeve të reja. Në anën tjetër, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), megjithëse ka përqindjen më të lartë të popullsisë (30.5%) dhe një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqes (25.6%), merr 17.3% të investimeve totale dhe 10.6% të investimeve të reja. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) paraqet një shpërndarje më të balancuar, ku përqindjet e investimeve janë më afër përqindjeve të popullsisë dhe sipërfaqes që ajo mbulon. Lista Serbe, përfaqëson 6.7% të popullsisë dhe 6.2% të sipërfaqes, përfiton rreth 2% të investimeve. Ndërkohë, subjektet më të vogla si KDTP, NISMA dhe Iniciativa Qytetare kanë një ndikim të kufizuar si në popullsi dhe sipërfaqe, ashtu edhe në investime.

¹⁰ Gazeta Zyrtare. [Ligji nr. 03/I-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.](#)

Figura 19. Gjithsej investimet dhe investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna 2026



Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

Komunat me investimet më të larta nga niveli qendror janë Gjilani me 30.7 milionë euro, Ferizaj me 21.4 milionë euro dhe Mitrovica me 19 milionë euro. Në anën tjetër, komunat me investimet më të ulëta janë Graçanica, Obiliqi dhe Zveçani.

Tabela 1. Shpërndarja e investimeve kapitale (216.6 milionë euro) nga ministrinë në komuna

Komuna	Gjithsej investime (€)	Gjithsej investime (%)	Investime për kokë banori (€)	Investimet e reja (€)	Investimet e reja (%)	Popullsia si numer	Popullsia (%)	Sipërfaqja (%)	Subjekti Politik
Gjilan	30,728,411	14.2%	370	2,005,000	13.3%	82,980	5.2%	3.60%	LVV
Mitrovicë	19,057,782	8.8%	294	500,000	3.3%	64,742	59.3%	3%	LVV
Ferizaj	21,388,125	9.9%			0.0%	109,255	6.8%	3.20%	PDK
Prishtinë	15,974,926	7.4%	70		0.0%	227,466	14.2%	4.70%	LDK
Gjakovë	15,536,070	7.2%	197	293,000	2.0%	78,699	4.9%	5.40%	AAK
Shtime	14,417,200	6.7%	593	900,000	6.0%	24,308	1.5%	1.20%	LVV
Kamenicë	10,169,551	4.7%	445	100,000	0.7%	22,868	1.4%	3.90%	LVV
Pejë	9,496,357	4.4%	115	581,000	3.9%	82,745	5.2%	5.50%	LDK
Podujevë	8,620,605	4.0%	121	1,600,000	10.6%	70,975	4.4%	5.80%	LVV
Prizren	8,070,300	3.7%	55	1,050,000	7.0%	147,246	9.2%	5.50%	PDK
Kaçanik	8,003,700	3.7%	289	1,100,000	7.3%	27,716	1.7%	1.90%	PDK
Deçan	7,522,000	3.5%	271	1,820,000	12.1%	27,775	1.7%	2.70%	AAK
Lipjan	6,133,000	2.8%	111	50,000	0.3%	55,044	3.4%	3.10%	LDK
Rahovec	6,063,200	2.8%	145	655,000	4.4%	41,799	2.6%	2.60%	AAK
Suharekë	5,153,500	2.4%	113	1,100,000	7.3%	45,749	2.9%	3.30%	AAK
F. Kosovë	4,200,000	1.9%	66		0.0%	63,949	4.0%	0.80%	LVV
Drenas	4,084,715	1.9%	85	150,000	1.0%	48,079	3.0%	2.50%	Iniciativa Qytetare
Skënderaj	3,991,516	1.8%	98	500,000	3.3%	40,664	2.5%	3.40%	PDK
Istog	3,656,430	1.7%	111	210,000	1.4%	33,008	2.1%	4.20%	LDK
Vushtrri	3,029,708	1.4%	49	300,000	2.0%	61,528	3.8%	3.20%	PDK
Shtërpçë	2,156,621	1.0%	200		0.0%	10,771	0.7%	2.30%	Lista Serbe
Klinë	2,095,043	1.0%	69	565,043	3.8%	30,503	1.9%	2.80%	AAK
Malishevë	1,817,000	0.8%	41	500,000	3.3%	43,888	2.7%	2.80%	NISMA
Dragash	1,000,000	0.5%	35	450,000	3.0%	28,896	1.8%	3.90%	LDK
Novobërdë	850,000	0.4%	189	50,000	0.3%	4,493	0.3%	1.90%	Lista Serbe
Viti	720,000	0.3%	20	300,000	2.0%	35,566	2.2%	2.50%	LDK
Hani i Elezit	524,292	0.2%	61		0.0%	8,533	0.5%	0.80%	PDK
Junik	450,000	0.2%	114		0.0%	3,943	0.2%	0.70%	LDK
Mamushë	413,500	0.2%	74		0.0%	5,607	0.3%	0.30%	KDTP
Ranillugut	400,000	0.2%	161		0.0%	2,481	0.2%	0.7%	Lista Serbe
Mitrovicë e V.	310,800	0.1%	39	246,000	1.6%	7,920	0.5%	0.04%	Lista Serbe
Klllokotit	250,000	0.1%	82		0.0%	3,041	0.2%	0.20%	Lista Serbe
Zvecanit	150,000	0.1%	52		0.0%	2,867	0.2%	1.10%	Lista Serbe
Obiliq	118,526	0.1%	5		0.0%	22,815	1.4%	1%	LDK
Graçanicë	50,000	0%	3		0.0%	18,486	1.2%		Lista Serbe

Burimi: Instituti GAP, më të dhëna nga Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, MFPT

Ministra e Financave vazhdon të mos e publikojë në kohë një informator për qytetarë rreth projektbuxhetit. Sipas praktikave të mira ndërkombëtare¹¹, Ministra e Financave duhet të përgatisë një dokument të shkurtër për qytetarë, ku shpjegohen të gjitha ndryshimet në projektbuxhetin e përgatitur, politikat e reja të reflektuara në buxhet, dhe më shumë. Por, në Kosovë ky dokument zakonisht publikohet pasi që të përfundojë i tërë procesi buxhetor, konkretisht miratimi i Ligjit të buxhetit.

Për herë të parë në shumë vite, projektbuxheti nuk është përgatitur bazuar në dokumentin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), në të cilin shtjellohen prioritetet që do të mbështeten me buxhetin në vijim, për t'u siguruar që financimi publik është në vijë edhe me objektivat strategjike. Kjo por edhe shumë nga politikat që shpesh dijnë të dizajnohen dhe zbatohen brenda vitit, flasin për një mungesë të ndërlidhjes së dokumentit të buxhetit me objektivat strategjike, për çka pastaj edhe vetë efekti i politikave në ekonomi, duke mos pas një vijueshmëri dhe arsyeshmëri, mbetet i kufizuar. Këtë vit, KASH 2026-2028 nuk është miratuar dhe publikuar fare nga Qeveria.


Shtyhet zbatimi i ligjit të ndryshuar për tatim në pronë për vitin 2027 përmes këtij ligji të buxhetit. Për të dytën herë më radhë, përmes Ligjit të buxhetit shtyhet zbatimi i shkallëve progresive të tatimit në pronë në bazë të vlerës totale të pronave të tatimpaguesve. Ashtu si herën e kaluar, edhe tash kjo shtyrje nuk është në harmoni me vetë Ligjin për tatimin në pronë.

Mungesa e perspektivës gjinore në projektbuxhet mbetet një problem i vazhdueshëm. Sikurse edhe në vitet e kaluara, në projektbuxhetin e vitit 2026 nuk përfshihet analizë mbi vlerësimin e ndikimeve të politikave buxhetore në barazinë gjinore, informacion mbi pasqyrën e prioritetëve të qeverisë për përmirësimin e barazisë gjinore apo masat buxhetore që synojnë në promovimin e barazisë gjinore

11 Instituti GAP. (2024). [Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit. Anketa e Buxhetit të Hapur 2023 – Kosova.](#)



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Instituti GAP përkrahet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Institutit GAP dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së apo Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**



**Sweden
Sverige**



FONDACIONI KOSOVAR PËR SHOQËRI CIVILE
KOSOVAR CIVIL SOCIETY FOUNDATION

